




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labor and Transfers
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi

TM2 2021 (2015=100)



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Parathënie

Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK) përkatësisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit ka filluar grumbullimin e të dhënave për çmimet e inputeve bujqësore në nëntor të vitit 2003. . Në fillim, numri i artikujve ishte i kufizuar. Me ndërrimin e vitit bazik nga viti 2003 në vitin bazik 2005, në 2010=100 është rrit edhe numri i inputeve (nga 15 në 23 inpute). Aktualisht grumbullohen çmimet për 77 inpute të ndryshme bujqësore.

Ky është publikimi i pesëdhjetë e tretë (53) mbi Indeksin e çmimeve të inputeve dhe Çmimet mesatare absolute të inputeve bujqësore përgatitur nga Agjencioni i Statistikës së Kosovës Në këtë publikim, janë paraqitur Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet për disa inpute kryesore bujqësore.

ASK-ja falënderon Agjencionin Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Kooperim (SIDA) për mbështetjen e tyre për ndërtimin e sistemit të statistikave agromonetare. ASK-ja, gjithashtu falënderon të gjithë bashkëpunëtorët e zyrave rajonale të ASK për bashkëpunim, , respondentët për ofrimin e të dhënave: fermat bujqësore, ndërmarrjet industriale dhe tregtare, etj.

Në veçanti, ASK-ja falënderon ekspertët suedezë të statistikave të çmimeve, z. Anders Grönvall dhe të tjerët, që në mënyrë të drejtpërdrejtë a indirekte ndihmuan në finalizimin e këtij publikimi

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim mund t'i dërgoni në email adresën e departamentit: **agriculture@rks-gov.net**

Publikimin e përgatitën:

Bajrush Qevani – Drejtor i departamentit,

Violeta Arifi – Gashi – Shefe e divizionit,

Florie Pireva – Zyrtare

Gusht 2021 Prishtinë

Zëvendësues i Kryeshefit Ekzekutiv i ASK-së,
z. Ilir T. Berisha

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	-	Agjencioni i Statistikës së Kosovës
IÇIIB	-	Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi
BE	-	Bashkësia Evropiane
SIDA	-	Agjencioni Ndërkombëtarë i Suedisë për Zhvillim dhe Kooperim
TM2	-	Tremujori i dytë
‰	-	Promil

Në tabelat ku janë dhënë peshat numrat janë rrumbullakuar deri në shifrën e fundit më të afërt për këtë arsye mund të ketë një mospërputhje të lehtë të shumave.

P ë r m b a j t j a

Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore.....	4
Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore TM2 2015-2021 (2015=100).....	5
Indeksi mujor i çmimeve të inputeve bujqësore prill – qershor 2021, (2015=100)	6
Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore prill –qershor 2021/2020(2015=100)	7
Metodologjia	8
Pyetëtori.....	9

Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore

Të dhënat e prezantuara në këtë publikim përfshijnë të dhëna për indeksin prej muajit prill deri në qershor të vitit 2021 (2015=100) që mbulon periudhën 2015-2021. Për të bërë krahasime dhe për të vërejtur ndryshimet janë prezantuar të dhëna për tremujoret e dytë (TM2) të viteve 2015-2021 me vitin bazik 2015, (2015 =100)

Publikimi bazohet në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinare, në kompani, tregje dhe vende tjera ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit (CPI) nga ASK.

ASK-ja ka bërë ndërrimin e vitit bazik nga 2010=100 në 2015=100 sipas metodologjisë së Eurostatit.


Produktet të cilat e përbëjnë bazën për Indeksin e çmimit të inputeve janë të ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). Brenda grupit të Mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëltues, energji; vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinarin, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime tjera. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje tjera), ndërtesat dhe tjera (ndërtesat jo-rezidente të fermës, punët tjera përveç përmirësimit të tokës).

Grafiku 1 tregon Indeksin e tremujorit të dytë të inputeve nga 2015 – 2021 për Inputet në përgjithësi si dhe për Inputet 1 dhe Inputet 2 (2015 = 100).

Ndryshimet e indeksit të tremujorit të dytë në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 (ndryshimi në %)

Indeksi i tremujorit të dytë të inputeve në vitin 2021 ka rritje për (3.4%) për **Input 1** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020. Indeksi për **Input 2** ka rritje për (4.0 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020. Indeksi i inputit të përgjithshëm (**Input 1 +Input 2**) ka rritje për (3.7 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Grafiku 1: Indeksi TM2 i çmimeve të inputeve 2015 – 2021, (2015 = 100)



Indeksi i çmimeve të inpleteve bujqësore TM2 2015-2020 (2015=100)
Tabela 1: Indeksi i Çmimeve të inpleteve bujqësore TM2 2015-2020, (2015=100)
Input 1 (Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi)

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	Pesha		TM2 2015	TM2 2016	TM2 2017	TM2 2018	TM2 2019	TM2 2020	TM2 2021
		%	1000 Euro							
200000	MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)	556	126,490	98.4	98.8	96.5	93.8	97.4	91.1	94.2
201000	FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	91	20,777	89.3	106.1	95.9	79.4	91.6	82.1	82.7
202000	ENERGJI; LUBRIFIKANT	103	23,433	101.3	90.1	99.3	104.8	106.4	85.3	99.9
202100	Energjia elektrike	17	4,637	88.9	86.4	97.8	98.2	95.6	95.6	93.1
202300	Lëndë djegëse	137	17,480	104.8	90.9	100.2	107.5	110.4	81.5	101.7
202400	Lubrifikant	3	1,316	98.4	93.9	92.6	92.6	91.9	99.0	100.5
203000	PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	149	33,958	100.1	98.1	89.1	85.7	89.1	88.4	87.8
203100	Plehrat e thjesht	56	12,777	99.8	94.1	86.8	83.2	85.9	85.8	85.7
203200	Plehrat e përbëra	93	21,181	100.2	100.6	90.4	87.3	91.0	90.0	89.1
204000	PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	23	5,137	97.7	104.1	103.9	105.0	105.9	103.3	103.4
205000	SHPENZIMET VETERINARE	38	8,732	100.0	97.7	98.5	97.5	100.0	92.7	100.7
206000	LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	3	741	97.6	113.1	102.2	103.2	108.6	113.4	118.5
206100	Lëndë të thjeshta ushqimi	104	630	97.8	115.7	101.8	103.8	109.5	111.5	117.0
206200	Lëndë të përbëra ushqimi	12	111	96.6	98.4	104.8	99.7	103.6	124.3	126.7
207000	MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	48	10,883	99.8	100.6	99.9	99.7	99.5	99.3	99.2
208000	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	4	833	100.0	98.5	98.7	98.4	99.7	101.8	102.3
209000	MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	97	21,996	100.1	99.8	101.0	100.7	101.5	101.2	100.7

Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)

210000	MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)	444	100,971	97.3	103.0	103.7	100.7	111.1	111.3	115.8
211210	TRAKTOR	208	47,375	94.8	107.0	107.8	101.6	121.3	120.4	128.3
211290	TJERA	236	53,596	99.5	99.4	100.1	99.9	102.1	103.3	104.7

Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)

220000	INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)	1,000	227,461	97.9	100.6	99.7	96.9	103.5	100.1	103.8
--------	--	-------	---------	------	-------	------	------	-------	-------	-------

Indeksi mujor i çmimeve të inpleteve bujqësore prill – qershor 2021, (2015=100)

Tabela 2: Indeksi mujor i çmimeve të inpleteve bujqësore prill – qershor 2021 , (2015 = 100)

Input 1 (Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi)						
Kodi i IÇPB	Përshkrimi	Pesha		2021		
		%	1000 Euro	Pri	Maj	Qer
200000	MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)	556	126,490	94.0	94.4	94.3
201000	FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	91	20,777	83.4	84.7	80.0
202000	ENERGJI; LUBRIFIKANT	103	23,433	98.9	99.4	101.4
202100	Energjia elektrike	17	4,637	90.5	90.5	98.2
202300	Lëndë djegëse	137	17,480	101.0	101.6	102.4
202400	Lubrifikant	3	1,316	100.5	100.5	100.5
203000	PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	149	33,958	87.5	87.6	88.3
203100	Plehrat e thjesht	56	12,777	84.8	85.1	87.1
203200	Plehrat e përbëra	93	21,181	89.1	89.1	89.1
204000	PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	23	5,137	102.9	102.9	104.5
205000	SHPENZIMET VETERINARE	38	8,732	99.6	101.1	101.5
206000	LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	3	741	120.1	121.3	114.1
206100	Lëndë të thjeshta ushqimi	104	630	118.9	120.3	111.9
206200	Lëndë të përbëra ushqimi	12	111	126.7	126.7	126.7
207000	MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	48	10,883	99.2	99.2	99.2
208000	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	4	833	102.2	102.2	102.7
209000	MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	97	21,996	100.9	100.7	100.7
Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)						
210000	MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)	444	100,971	116.3	116.3	117.7
211210	TRAKTOR	208	47,375	128.3	128.3	128.3
211290	TJERA	236	53,596	105.6	105.6	108.3
Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)						
220000	INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)	1,000	227,461	103.9	104.1	104.7

Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore prill – qershor 2021/2020(2015=100)

Tabela 3: Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore prill – qershor 2021 / 2020 (2015= 100)

Input 1 (Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi)

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	Pesha		Pri21/ Pri20 Ndrysh. në %	Maj 21 / Shk20 Ndrysh. në %	Qer21 / Qer 20 Ndrysh në %
		%	1000 Euro			
200000	MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)	556	126,490	3.1	3.5	3.7
201000	FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	91	20,777	2.4	2.0	-2.4
202000	ENERGJI; LUBRIFIKANT	103	23,433	15.1	18.0	18.2
202100	Energjia elektrike	17	4,637	-5.3	-5.3	2.7
202300	Lëndë djegëse	137	17,480	22.7	26.9	24.6
202400	Lubrifikant	3	1,316	1.5	1.5	1.5
203000	PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	149	33,958	-1.6	-1.5	1.0
203100	Plehrat e thjesht	56	12,777	-1.6	-1.4	2.7
203200	Plehrat e përbëra	93	21,181	-1.5	-1.5	0.1
204000	PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	23	5,137	-1.0	-0.1	1.6
205000	SHPENZIMET VETERINARE	38	8,732	9.5	8.1	8.6
206000	LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	3	741	6.5	7.9	-0.9
206100	Lëndë të thjeshta ushqimi	104	630	8.5	8.5	-1.9
206200	Lëndë të përbëra ushqimi	12	111	-3.1	4.6	4.6
207000	MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	48	10,883	-0.1	-0.1	0.0
208000	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	4	833	0.4	0.3	0.9
209000	MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	97	21,996	-0.5	-0.5	-0.5

Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)

210000	MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)	444	100,971	3.8	3.8	4.9
211210	TRAKTOR	208	47,375	6.6	6.6	6.6
211290	TJERA	236	53,596	1.0	1.0	3.3

Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)

220000	INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)	1,000	227,461	0.6	1.1	2.8
--------	---	--------------	----------------	------------	------------	------------

Metodologjia

Çmimet dhe indekset e çmimeve në këtë publikim janë kalkuluar sipas standardeve për statistikat e çmimeve të Bashkimit Evropian. Projekti për kalkulimin e këtyre çmimeve dhe indekseve të çmimeve është realizuar brenda projektit për “Përmirësimin e statistikave agromonetare” në bashkëpunim me Statistikat Suedeze dhe me mbështetjen financiare nga SIDA (Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar).

Çmimet janë grumbulluar në shtatë regjione: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Çmimet janë grumbulluar çdo muaj rreth datës 15. Që nga fillimi numri i artikujve për të cilët janë grumbulluar çmimet është rritur hap pas hapi.

Qëllimi i Indeksit të çmimit të inputeve bujqësore është përcjellja e çmimeve të blerjes të mjeteve për prodhim bujqësor. Sipas definicionit, indeksi nuk i mbulon faktorët e prodhimit. Rrjedhimisht, rrogat dhe kostoja e rrogave, qiraja, pagesa e kamatës, blerja e tokës dhe kafshët si asete fikse nuk janë pjesë e fushë-vëzhgimit.

Për të krahasuar indeksin e BE-së të paraqitur në këtë publikim me shtetet tjera, rekomandohet faja elektronike e Eurostat-it (<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/eurostat/home>).

Peshat për kalkulimin e indekseve të agreguara kryesisht janë bazuar në Llogaritjet ekonomike bujqësore 2015, që është viti bazë në indeks (2015=100). Këto pesha janë fikse përderisa baza e indeksit është viti 2015. Indeksi është indeks i çmimit dhe kalkullohet bazuar në formulën e *Laspeyres*.

Llogaritja e indeksit elementar të çmimit

Llogaritja e indekseve elementare është bërë në përgjithësi duke përdorur formulat në vijim, me çmim mesatar aritmetik të papeshuar.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^0} \cdot 100$$

R_i^t – Indeksi elementar për muajin t dhe prodhimin i

P – Çmimi i grumbulluar

i – Prodhimi i

j – Çmimi j i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për regjionin)

t – Muaji i vëzhguar

0 – Muaji bazë

Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimit

Llogaritja e indeksit të agreguar për totalin e inputeve ose nëngrupeve të indeksit të inputeve është bërë duke shfrytëzuar formulën në vijim.

$$I^t = \sum \left(R_i^t \cdot \frac{w_i^0}{\sum w_i^0} \right)$$

I^t - Indeksi i agreguar për periudhën t

W_i^0 - Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin i

i - Prodhimi i

t - Muaji i vëzhguar

0 - Muaji bazë

Pyetëtori

DEFINICIONI -Përcaktimi i cakt (artikujve- vareteteve)

Numri i artikullit	Emri i artikullit			Sasia	Njësia
	Grumbulluesi i çmimit			Vendi i grumbullimit / Ndërmarrja	
Data					
Çmimi					

Shënimet e anketuesve

- Përshkrimi hollësishëm i artikullit (varietetit) specifik të zgjedhur për monitorim të çmimit
- Ndryshimet në përshkrimin e hollësishëm, data e ndryshimeve
- Trajtimi i ndryshimit të kualitetit kur përshkrimi është ndryshuar (informacionet e vrojtimit të dyfishta të çmimit, plotësuese dhe vlerësimi i ndryshimit të kualitetit)

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili kua hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka ketë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistrues terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>